



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 33160/24

Nr. i fq. / Br. sh. _____

Data: / Datum: 10.07.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri

**Procesverbali nga dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Dumnicë e
Llugës, Dumnicë e Poshtme dhe Dumnicë e Epërme**

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik më qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025, mbajtur me banorët e Këshillit Lokal Dumnicë e Llugës, që përfshin fshatrat Dumnicë e Llugës, Dumnicë e Poshtme dhe Dumnicë e Epërme.

Vendi: Shkolla “Bajram Curri” Dumnicë e Llugës

Ora: 19:30

Data: 09.07.2024

Të pranishëm nga Komuna ishin: Qemajl Hasani, nga drejtorja për Financa, Buxhet dhe Financa, Izet Miftari, drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Donjeta Latifi.

Qemajl Hasani, kryesues, hapi mbledhjen me qytetarë, ku edhe paraqiti buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025 dhe projektet e parapara për fshatrat e Këshillit Lokal Dumnicë e Llugës.

Gjithashtu, qytetarëve të pranishëm në këtë dëgjim ju është shpërnda material informues për buxhetin e vitit 2024.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët pjesëmarrës në këtë takim për të paraqitur kërkesat e tyre.

Latif Latifi, banor i fshatit Dumnicë, tha se furnizimi me ujësjellës është kërkesa kryesore e këtij fshati pasi që uji i bunarëve(puseve) është i papijshëm. Gjithashtu kishte kërkesë për asfaltimin e rrugës “Salih Haliti” 200m asfaltim, në këtë kërkesë qytetari theksoi se është shumë i vështir kalimi me veturë dhe po dëmtohen veturat shumë shpesh.

Sabit Rustolli, banor i fshatit Dumnicë, tha se furnizimi me ujësjellës është kërkesa kryesore e këtij fshati, gjithashtu kërkoi që të asfaltohet rruga nga Xhamia deri tek Kodront, “Rr.Qërim Kodroni” 200m asfaltim.

Ajet Ismajli, banor i fshatit Dumnicë, tha se ujësjellësi është primar për këto tri fshatra, çdo rrugë e fshatit është mirë të shtohet por primare janë ato rrugë ku ka më shumë banor e sidomos nxënës. Tek Lagja Sokoli 37 shtëpi nuk kanë kanalizim.

Behxhet Ismaili, banor i fshatit Dumnicë e Llugës, tha se rruga “Ramadan Ismaili” është dëmtuar të asfaltohet 100m dhe nuk ka kanalizim. Gjithashtu edhe rruga e Abazve të asfaltohet 150-200m këto dy rrugë janë primare. Kanalizimi është kërkesa kryesore e lagjes Sokoli. Shtylla e ndriçimit publik është e thyer në Dumnicë të Poshtme.

Murat Rustolli, banor i fshatit Dumnicë e Llugës, tha se është dëmtuar rruga “Agush Rustolli” dhe të asfaltohet, shaktat e kanalizimit janë dëmtuar. Është bërë një lloj deponie e mbeturinave. Në rrugën kryesore të fshatit është dëmtuar ndriçimi publik dhe në disa rrugica.

Shemsi Rustolli, banor i fshatit Dumnicë, tha se është dëmtuar ndriçimi publik, duhet të rregullohen sa më parë.

Enver Xheladini, banor i fshatit Dumnicë, tha se kërkesat kryesore të fshatit janë furnizimi me ujësjellës, kanalizimi dhe ndriçimi publik këto kërkesa janë të përsëritura.

Raif Latifi, banor i fshatit Dumnicë, tha se furnizimi me ujësjellës është kërkesa kryesore e këtij fshati. Gjithashtu kishte kërkesë për asfaltimin e rrugës Salih Haliti 200m asfaltim.

Faik Beka, banor i fshatit Dumnicë, kërkoi që të asfaltohet rruga “Haxi Nazifi” në këtë rrugë lidhen 6 shtëpi.

Takimi me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025, mbajtur me banorët e Këshillit Lokal Dumnicë e Llugës, që përfshin fshatrat Dumnicë e Llugës, Dumnicë e Poshtme dhe Dumnicë e Epërme, përfundoi në ora 20:30.

Në këtë takim morën pjesë 13 qytetarë.

Procesmbajtëse:

Mirjeta Duraku





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2025

Vendi: Dumnice e Llugës

Datë: 09.07.2024

Ora: 19:30

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Ajet Ismaj	A. Ismaj	Dumnice
2	Latif Latifi	Latif	Dumnice
3	Sabit Rustoll	S. Rustoll	Dumnice
4	Shenke Rustoll	Sh. Rustoll	Dumnice
5	SABRI AVDIU	S. Avdiu	DUMNICE
6	Rafik Latifi	R. Latifi	DUMNICE
7	Edin BEKRI	E. Bekri	Dumnice
8	Behxhet Ismaj	B. Ismaj	Dumnice
9	Manat Rustoll	M. Rustoll	Dumnice
10	Hysni Haliti	H. Haliti	
11	VALON HYSENI	V. Hyse	DUMNICE
12	Emver Xheladin	E. Xheladin	Dumnice
13	VALTRIN XHELADIN	V. Xheladin	
14			
15			
16			